


**RAPORT  
MBI  
MONITORIMIN E RRJETIT AKTIV GJEODEZIK ALBCORS  
PËR VITIN 2024.**



## **MONITORIMI I RRJETIT GJEODEZIK AKTIV ALBCORS PËR VITIN 2024.**

Stafi i sektorit së Infrastrukturës së Sistemeve CORS ka përgatitur raportin e monitorimit të Rrjetit Gjeodezik Aktiv ALBCORS në bazë të monitorimit të përditshëm të përdoruesve të këtij rrjeti. Më poshtë janë trajtuar dhe paraqitur në mënyrë të detajuar të gjitha llojet dhe tipologjitë e zgjidhjeve për shërbimin që kanë përdorur përdoruesit gjatë vitit 2024.

Bazuar në platformën GNSMART të Geo++, është realizuar shkarkimi i të dhënave nga platforma për përdorimin e shërbimit RTK të Rrjetit Gjeodezik Aktiv ALBCORS nga të gjithë përdoruesit e këtij rrjeti për vitin 2024. Përmes këtyre të dhënave janë kryer një sërë analizash të ndryshme për mënyrën e qasjes së përdoruesve në lidhje me Rrjetin Gjeodezik Aktiv ALBCORS.


Gjatë vitit 2024 janë realizuar **189735** lidhje me Rrjetin Gjeodezik Aktiv ALBCORS nga e cila vërehet që tendenca e përdorimit të këtij rrjeti ka ardhur në rritje të madhe progresive. Kjo rritje e përdorimit të këtij shërbimi është një tregues shumë domethënës për qëndrueshmërinë që ofron ky rrjet si dhe seriozitetin edhe kompetencën e treguar nga sektori përkatës.

Gjithashtu kjo analizë e treguar më poshtë do jetë bazë e rëndësishme për grupin e punës për të referuar tarifimet e mundshme për shërbimet që ofron ky rrjet.

Më poshtë është paraqitur analiza e bërë mbi mënyrën e përdorimit, tipologjinë e shërbimit dhe shpërndarjen gjeografike të përdoruesve të këtij rrjeti.

- 1- Në skemën e mëposhtme është treguar shpërndarja gjeografike e të gjitha lidhjeve të realizuara gjatë vitit 2024, pra në total kemi **189735** lidhje për të gjithë tipologjinë e zgjidhjeve për lidhjet e realizuara (quality indicator). Krahasuar me një vit më parë (2023) numri total i lidhjeve ka qenë **85822** lidhje.

**PËRDORIMI I RRJETIT GJEODEZIK AKTIV ALBCORS 2024**



**Legjenda**

2024

**QUALITY INDICATOR**

- FIX NO VALID
- GPS FIX
- DGPS
- RTK FIX
- RTK FLOAT


- 2- Në tabelën e mëposhtme janë afishuar të dhënat statistikore mujore të lidhjeve të përdoruesve në të cilën duket qartë tendenca në rritje dhe zgjidhja e ofruar për lidhjet e realizuara.

<b>TABELA MBI TE DHENAT E SHERBIMIT ALBCORS PER VITIN 2024</b>						
<b>MUAJI</b>	<b>NR. I LIDHJEVE</b>	<i>0 - FIX NO VALID</i>	<i>1 - GPS FIX</i>	<i>2 - DIFFERENTIAL GPS FIX</i>	<i>4 - RTK FIX</i>	<i>5 - RTK FLOAT</i>
JANAR	10782	18	2202	206	6570	1786
SHKURT	14516	11	1188	279	9529	3509
MARS	12272	20	938	226	8839	2249
PRILL	12097	5	1169	199	9036	1688
MAJ	20508	17	7606	259	10407	2219
QERSHOR	15322	104	2734	365	9550	2569
KORRIK	14095	19	1403	351	10334	1988
GUSHT	12858	29	1630	302	9047	1850
SHTATOR	14861	19	1480	423	10277	2662
TETOR	17028	19	2346	355	11875	2433
NENTOR	33911	33	21316	650	9548	2364
DHJETOR	11341	63	1558	343	7438	1939
<b>TOTAL</b>	<b>189591</b>	<b>357</b>	<b>45570</b>	<b>3958</b>	<b>112450</b>	<b>27256</b>
<b>%</b>	<b>100%</b>	<b>0.19%</b>	<b>24.04%</b>	<b>2.09%</b>	<b>59.31%</b>	<b>14.38%</b>

3- Më poshtë tregohet me i qartë numri total i lidhjeve për çdo muaj në formë grafiku duke krahasuar vitin 2024 me vitin paraardhës 2023.



4- Në grafikun e mëposhtëm tregohen lidhjet mujore sipas tipologjisë së zgjidhjes, për çdo muaj gjatë vitit 2024.



5- Në grafikun e mëposhtëm tregohet në formë përqindje (%) se si është intensiteti i tipologjisë së zgjidhjes së përfutur për lidhjet e realizuara gjatë gjithë vitit 2024:

